



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
PERMET.

RAPORTI VJETOR

Në Përmet me 21.02.2017.

Në përputhje dhe zbatim të Kushtetutës së Shqipërisë, Kodit të Procedurës Penale, ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Urdhërit nr.330 datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm paraqesim raportin vjetor.

1Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet, për vitin 2016 ka respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut të parashikuara dhe sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventen Europiane të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Kodin e Procedurës Penale dhe aktet e tjera ligjore, për gjithë personat e përfshirë në hetime, pavarësisht rolit që kanë pasur të dëmtuar nga vepra penale, të pandehur, interesuar ose dëshmitar.

1.1Për vitin 2016 në Prokurorinë Përmet është regjistruar një procedim penal me të pandehur të mitur për veprën penale të “Falsifikimit të monedhave” parashikuar nga neni 183 K.Penal. Me konstatimin e moshës së të miturit, nuk është kryer asnjë veprim hetimor, çështja është transferuar Seksionit të të Miturveve në Prokurorinë Pranë Gjykatës Shkallës Parë Gjirokastër.

Në një rast për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130a/4 K.Penal me të dëmtuar i mitur 12 vjec, janë respektuar procedurat e pyetjes së tij dhe të drejtat që parashikon Kodi Procedures Penale si në prokurori dhe gjykatë.

Në hetimin e një çështje për veprën penale të “Mardhenie seksuale me dhunë me të mitura nga 14-18 vjec” parashikuar nga neni 101/1 K.Penal , me të dëmtuar e mitur 16 vjeçe, deklaratimet e saj janë marrë në prezencë të prinderit, psikologes dhe është lejuar përfaqësimi të dëmtuarës me avokat në të gjitha fazat e hetimit paraprak.

1.2Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qënë përgjithësisht i mirë dhe pa problematika të theksuara.Në vitin 2017 kërkohet dhe do të vihet theksi në një bashkëpunim më të madh dhe efikas me Sherbimet e Policisë së Shtetit si dhe me organet e qeverisjes vendore në luftën kundër

krimin të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal, pasi është kthyer në një problem shqetësues për rrethin Përmet. Vlen për t’u veçuar bashkëpunimi shumë i mirë me Zyrën e Përmbarrimit Gjyqësor Përmet, Shërbimin e Provës Përmet. Me Gjykatën Shkallës Parë Përmet, organet e qeverisjes vendore, drejtorite rajonale që operojnë në rrethin Përmet ekziston një bashkëpunim i mirë.

1.3 Sa i përket, përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe hetimeve proaktive, ato janë kryer në tre raste. Në hetimin për veprën penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 K.penal, për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativa parashikuar nga neni 78/2-22 K.Penal dhe në një procedim për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal.

1.4 Nuk ka pasur asnjë procedim penal në lidhje me procesin e verifikimit të integritetit të personave që ushtrojnë detyra shtetërore ose funksione publike.

1.5 Problematik paraqet kontrolli dhe mbikqyrja e punës procedurale dhe ligjore të prokuroreve. Me ndryshimet e fundit konstatohet përplasja, midis ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” me parashikimet që janë në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me pozicionin, të drejtat dhe detyrat e prokurorit më të lartë dhe roli tij në kontrollin e ligjshmerisë së vendimarrjes nga prokuroret. Aktualisht prokurori më i lartë nuk ka asnjë të drejtë dhe as mundësi të kundërshtoj, ndryshoj, shfuqizoj vendimarrjen e prokurorit më të ulët, kur e vlerëson vendimarrjen si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe asnjë organ ku mundet të kundërshtoj vendimarrjet që i konstaton të pabazuara.

2. Për vitin 2016 janë rregjistruar në total 236 materiale kallëzuese, nga të cilat 162 janë rregjistruar si procedime penale, 42 procedime penale janë mbartuar nga viti 2015, në total janë hetuar 204 procedime dhe 74 kallëzime.

2.1 Çështje të përfaqësuar në gjykatë.

Janë përfaqësuar 52 çështje në gjykatë me 80 të pandehur, 41 çështje janë dërguar për gjykim në vitin 2016 dhe 11 çështje janë mbartuar nga viti 2015.

Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar për 39 çështje, me 48 pandehur, 39 janë dënuar dhe 9 të pandehur kanë marrë pafajësi në shkallë të parë.

Prokurorët kanë marrë pjesë si palë e tretë (interesuar) në 10 gjykime penale me të dëmtuar akuzues.

Janë dërguar me gjykim të drejtpërdrejt 5 çështje me 6 të pandehur.

Janë marrë 6 pafajësi të plota me 7 të pandehur dhe 2 pafajësi të pjesëshme me 2 të pandehur. Ka mbi 2 vjet që një ceshtje penale ndodhet në proces gjyqësor në shkallën e parë, me dy të pandehur, 1 me masë sigurimi arrest në burg akuzuar për veprën penale të “Mashttrimit në bashkëpunim” me pasoja të rënda parashikuar nga neni 143/3 K.Penal.

2.2 Mënyra e përfundimit të ceshtjeve të hetuara.

Për vitin 2016 nga 204 procedime penale janë përfunduar 135 procedime penale duke vendosur si më poshtë.

- Dërguar për gjykim 41 procedime penale, me 66 të pandehur nga të cilët 23 janë hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale, -10 detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, -2 arrest në shtëpi, -31 në gjendje të lirë
- Pushuar 49 procedime penale me 19 persona në hetim.
- Pezulluar 37 procedime.
- Shpallur moskompetenca dhe kalimi akteve për 8 procedime penale, transferuar 7 për mungesë kompetence tokësore dhe një mungesë kompetence lëndore, me 8 persona në hetim.
- Janë mbartuar 69 procedime, me 21 persona në hetim nga të cilët, 2 arrest në burg, -2 arrest në shtëpi, -4 detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, -14 në gjendje të lirë.
- Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 75 materiale kalëzuese.

*Në total për vitin 2016 janë hetuar **115 persona** nga të cilët 66 janë marrë të pandehur, për 19 persona janë pushuar hetimet, - 8 persona është shpallur moskompetenca dhe kalim aktesh, 22 persona janë në hetim dhe mbarten për vitin 2017.*

Janë përfunduar tej afatit tre muajor 22 procedime penale me 27 persona në hetim, për 11 procedime është marrë zgjatje të afatit nga një muaj deri në tre muaj. Zgjatje afati deri në në gjashtë muaj është marrë për 5 procedime penale. Mbi 6 muaj është marrë për 3 procedime penale dhe deri në një vit për dy procedime penale.

2.3 Burimet e njoftimeve të veprave penale janë ato klasiket dhe zakonshmet, me përjashtim se për vitin 2016 janë regjistruar kryesisht 2 procedime penale.

- Shërbimet e policisë pranë Komisarariatit të Policisë Përmet dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokaster kanë referuar 168 raste, kryesisht janë:

Referuar 38 raste për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal, 16 raste për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 K.Penal, 9 referime për faktin e “Vetevrasjes” ose ndryshe për nenin 99 K.Penal, 6 herë për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130a K.Penal.

- Nga shërbimet e policisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë janë kryer; 4 njoftime për faktin e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penal, 4 njoftime për veprat penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 K.Penal dhe “Drejtimin pa dëshmi të automjetit” parashikuar nga neni 291 K.Penal, 2 njoftime për veprën penale të “Plagosje rënde me dashje” parashikuar nga neni 88/1 K.Penal, 2 njoftime ose referime për veprën penale të “Shkeljes së pronesisë intelektuale” parashikuar nga neni 149a K.Penal, 1 njoftim për veprën penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 K.Penal, 1 njoftim për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë parashikuar nga neni 78/2-22 K.Penal, 1 rast për veprën penale të “Pastrim të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 K.Penal.
- Shtetasit kanë njoftuar për 41 raste, kryesisht për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 K.Penal, “Shpërdorimi detyrës” parashikuar nga neni 248 K.Penal, “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 K.Penal dhe për kundërvajtje penale që ndiqen me ankim ose me kërkesë të dëmtuarit akuzues.
- Nënpunësit publik dhe organet e tjera kanë referuar 25 raste.
- Kryesisht janë regjistruar dy procedime penale, për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal dhe veprën penale të “Pastrim të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 K.Penal.

Veprat penale me shume të regjistruar dhe hetuara për vitin 2016 janë;

Neni 76 K.Penal 1 procedim.

Neni 78 K.Penal 2 procedime,

Neni 88/1 K.Penal 2 procedime.

Neni 130a K.Penal 5 procedime.

Neni 134 K.Penal 21 procedime.

Neni 150 K.Penal 4 procedime.

Neni 151 K.Penal 5 procedime.

Neni 186 K.Penal 8 procedime.

Neni 205 K.Penal 5 procedime.

Neni 248 K.Penal 4 procedime.

Neni 275 K.Penal 7 procedime.

Neni 283 K.Penal 4 procedime.

Neni 284 K.Penal 40 procedime.

Neni 290 K.Penal 3 procedime.

Neni 291 K.Penal 3 procedime

Neni 297 K.Penal 5 procedime

Neni 320 K.Penal 2 procedime

Neni 321 K.Penal 3 procedime

2.4 Nga 115 persona në hetim, për vitin 2016, 24 persona janë hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale, 4 me “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.Pr.Penal, 10 me masen e sigurimit personal “Detyrim paraqitje ne policine gjyqësore” parashikuar nga neni 234 K.Pr.Penale.

Janë arrestuar në flagrancë dhe ndaluar në përputhje me nenet 251,252 dhe 253 K.Pr.Penale me iniciativë të policisë 17 persona.

Janë arrestuar 3 persona për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a K.Penal, nje për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284/2 K.Penal, nje person për veprën penale të “Plagosje rende me dashje” parashikuar nga neni 88/1 K.Penal, nje person për veprën penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 K.Penal, dy për veprat penale të “Shklejtes se rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1 K.Penal, “Drejtim te automjetit ne gjendje te parregullt” parashikuar nga neni 291 K.Penal nje për veprën penale të “Shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/3 K.Penal.

Të ndaluar janë 7 persona; Tre te pandehur për veprat penale të “Shkatërrimit të pronës” parashikuar nga neni 150 K.Penal, “Prishje qetesise publike” parashikuar nga neni 274 K.Penal.1 për veprën penale të “ Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a K.Penal dhe “Pengimi te ekzekutimit te vendimit gjyqësor” urdhërit të mbrojtjes parashikuar nga neni 320 K.Penal.Një per veprën penale të “ Largimit nga vendi ngjarjes” parashikuar nga neni 273 K.Penal.Nje pandehur për veprën penale të “Kanosjes” parashikuar nga neni 84 K.Penal, “Prodhim dhe mbajtje pa leje armeve te gjuetisë” parashikuar nga neni 280 K.Penal dhe një është ndaluar për veprën penale të “ Ngacmimit seksual” parashikuar nga neni 108a/2 K.Penal.

Prokuroria ka kërkuar për 9 të arrestuar dhe ndaluar masën e sigurimit personal “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale dhe për 8 të tjerë detyrim paraqitje ne policinë gjyqësore. Gjykata ka pranuar kërkesat me perjashtim te nje rasti ka vendosur arrest shtepie, të akuzuar për veprën penale të “ Ngacmimit seksual” parashikuar nga neni 108a/2 K.Penal.

- Me iniciativë dhe kërkesë të prokurorit në fazën e hetimit paraprak, janë caktuar 6 masa sigurimi personal.

Është kërkuar për 3 persona në hetim dhe vendosur nga gjykata, masa e sigurimit personal “Arrest brurg” parashikuar nga neni 238 K.Pr.Penale në mungesë të akuzuar per kryerjen e veprave penale te “Vrasjes ne lidhje me nje krim tjetër” parashikuar nga neni 77-22 K.Penal, “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armeve luftarake” parashikuar nga neni 287/2 K.Penal dhe “Prodhim dhe shtije narkotikeve” parashikuar nga neni 283/2 K.Penal.Për një të dyshuar për kryerjen e vepres penale te “Vrasjes me paramendim” në tentative parashikuar nga neni 78/2-22 K.Penal,çeshtja është ne hetim.Një masë sigurimi “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 K.pr.Penale dhe një detyrim paraqitje ne policinë gjyqësore.

Janë urdhëruar dy ndalime nga prokurori për dy persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “ Moskallëimit të krimit” parashikuar nga neni 300 K.Penal dhe “ Përkrahjes së autorit në krim” parashikuar nga neni 302 K.Penal,një urdhër ndalimi është ekzekutuar.

- Janë mbartuar nga viti 2015, 42 procedime penale me 11 persona me masë sigurimi arrest në burg .
- Është kërkuar shpallja e ikjes për 6 të pandehur, të gjashtë me masë sigurimi arrest në burg, kërkesa të miratuara nga gjykata.

2.5 Në zbatim të vendimeve penale të formës së prera është urdhëruar ekzekutimi dënimeve penale për 49 të dënuar. Urdhërat e ekzekutimit, janë nxjerr në afatet dhe procedurat të përcaktuara nga nenet 463-468 të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Për të dënuarit për kundërvajtje penale janë nxjerrë 15 urdhëra ekzekutimi dhe për të dënuarit për krime 34 urdhëra ekzekutimi.

Për të dënuarit me burg urdhërat e ekzekutimit janë nxjerr në respektim të afatit 24 orë nga momenti që vendimi formës prerë është njoftuar ose komunikuar prokurorit.

Nuk janë vënë në ekzekutim, në vitin 2016 tre urdhëra, për një të dënuar me 1 vit e 6 muaj burg për veprën penale të “Mashtrimit” parashikuar nga neni 143/1 K.Penal. Ende pa u ekzekutuar urdhëri për një të dënuar për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” parashikuar nga neni 199a/2 K.Penal dënuar me katër muaj burg dhe për një të dënuar për veprën penale të “ Moskallëzimit të krimit” parashikuar nga neni 300 K.Penal, me 10 muaj burg.

2.6 Konstatohet një shtrirje dhe rritje jo llogjike dhe normale e kriminalitetit në zonat rurale dhe konkretisht përfshirja e këtyre zonave në kultivimin e bimeve narkotike dhe për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 ka një trefishim të krimit të “Kultivimit të bimeve narkotike” dhe “Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve” parashikuar nga nenet 283 dhe 284 K.Penal dhe tashmë është një fenomen **shqetësues dhe kërcënues për këto zona**. Këto krime, në një rast kanë sjellë dhe pasoja të rënda në jetë njerëzore. Një vrasje që ka ndodhur për shkak të konfliktit për posedimin e parcelave të kultivimit të lëndëve narkotike.

Nga 38 referimet e kryera nga shërbimet e policisë për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal vetëm në një rast është mundur të identifikohet dhe merret në përgjegjësi penale një person si kultivues. Në të gjitha rastet e tjera nuk janë identifikuar, kultivuesit, financuesit dhe bashkëpunorë ose persona të përfshirë në këtë aktivitet të paligjshëm dhe nuk është identifikuar asnjë pronar i parcelave pavarësisht se tokat bujqesore janë ndarë banorëve të fshatrave ku është konstatuar kultivimi i lëndës narkotike.

Një numër mjaft të madh të veprave penale të regjistruara për vitin 2016 e zë dhe vepra penale e vjedhjes me 21 procedime të regjistruara, por pa shkaktuar pasoja të rënda materiale. Kryesisht janë për vjedhje ose humbje sendesh personale (celular dhe sende të tjera të ngjashme) dhe vjedhje në banesa të pabanuara dhe braktisura nga pronaret e tyre prej vitesh. Në krahasim me vitin 2015 dhe vitet para ardhëse ka një rënie të veprës penale të “Vjedhjes” si për nga numëri procedimeve, pasojave dhe rrezikshmërisë, kryesisht kjo vepër penale është e përhapur në qytetin Përmet dhe Këlcyrë.

Konstatohet rritje e kriminalitetit, krimeve të rënda në krahasim me vitin 2015 dhe vitet parardhese dhe konkretisht të veprave penale të parashikuara nga nenet 76,78 283,284 K.Penal.

2.7 Sipas strukturës të Kodit Penal konstatohet një shtim i krimeve që parashikojnë dënim në maksimum me burg mbi shtatë vjet dhe më konkretisht për veprat penale e “Prodhim dhe shitje e narkotikeve” parashikuara nga neni 283 K.Penal, “Kultivim të bimëve narkotike” parashikuara nga neni 284/2 K.Penal që ka marrë një përhapje shumë të madhe si në territorin e rrethit Përmet dhe në numerin e procedimeve të regjistruara dhe hetuara nga prokuroria duke zënë 25 përqind të çështjeve të hetuar për vitin 2016. Ka shtim të krimeve kundër jetes dhe shëndetit të kryera me dashje me pasoja të rënda sic janë vrasjet dhe plagosjet e rënda.

Ka një rritje të konsiderueshme të veprave penale kundër rendit dhe sigurisë në total janë regjistruar 66 procedime penale, duke kapur kështu shifrën më të madhe të procedimeve të regjistruara dhe hetuar për vitin 2016 dhe një dyfishim krahasuar me vitin 2015.

Ka një dyfishim të krimeve kundër jetës të kryera me dashje, 8 procedime të hetuara dhe në krahasim me 2015 janë dyfishuar dhe pasojat që kanë sjellë në jetën dhe shëndetin e të dëmtuarave janë fatale.

Ka rritje të kundervajtjeve penale dhe veprave penale kundër mjedisit për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, janë hetuar 6 procedime penale.

Konstatohet rënie e krimeve kundër pasurisë në krahasim me vitin 2015 dhe pasojave materiale që këto krime kanë sjellë.

3. Për vitin 2015 janë hetuar 137 procedime penale me 95 persona në hetim, 45 procedime penale me 52 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar në vitin 2015, 24 të pandehur, 4 janë shpallur të pafajshëm dhe për 24 të pandehur është mbartuar gjykimi për vitin 2016 dhe për pesë të pandehur gjykimi vazhdon të mbartet dhe për vitin 2017.

3.1 Për vitin 2016 janë dërguar për gjykim 41 procedime penale me 66 të pandehur, 23 janë gjykuar me masë sigurimi “arrest burg”, 10 detyrim paraqitje në policinë gjyqësore dhe 2 arrest në shtëpi.

Kanë përfunduar gjykimin 31 çështje me 34 të pandehur, janë dënuar 28 persona dhe 6 kanë marrë pafajësi.

V.P.K/Shendetit me dashje.	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 88/1 Plagosje rwndw me dashje	1		1			2	2	2	2	1 neni 59
Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje	4	3	3	3	3 gjobe	1	1	1	1	
Neni 99 Shkaktimi vetevrasjes						1				
Totali	5	3	4	3	3	4	3	3	3	1
V.P./ Seksuale	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 108a Ngacmimi seksual	1	1	1	1		1		1		1 neni 59
Totali	1	1	1	1		1		1		1
V.P.K/ Femijeve, familjes	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar

		im		im			im	j	im	
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
V.P.K/Femijeve, Familjes										
Neni 127 Marrja padrejte e femijes						1		1		
Neni 130a/1 Dhune nw familje	5	1	3	3		4	4	5	4	6
Neni 130a/4 Dhunw nw familje ne prani te femijeve						2	1	2	1	1neni 59
Totali	5	1	3	3		6	5	8	5	7
V.P.K/Pasurise	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 134/ Vjedhje	24	3	3	3	3	20	1	3	1	1
Neni 134/2 Vjedhje ne bashkepunim	2	2	4	4	Jan-00	1	1	2	2	2neni 59
Neni 134/3 Vjedhje me pasoja tw rwnda	1	1	2	2	1					1burg mesa
Neni 135 Vjedhje duke shperdoruar detyren	1		1							
Neni 137/1 Vjedhje energjise elektrike	2	2	2	2	2 me neni 59	1	1	1	1	2
Neni 137/2 Vjedhje energjise me pasoja	1	1	1	1						1-neni 59

Neni 139 Vjedhje me dhune	1					1				
Totali	32	12	13	12	10	23	3	6	4	7
V.P/ Mashtrimet	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 143/1 Mashtrimi	2	2	3	2		1				1burg +1pafaj
Neni 143/2 Mashtim nw bashkwpunim	3	1	2	2						
Neni 149a Shkelja pronwsisw intelektuale.						3		3		
Totali	5	3	5	2		4		3		1
V.P/Shkaterrimite prones	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 150 Shkatwrrimi pronws	3					2	1	3	2	
Neni 151 Shkaterrim prone me zjarr	8					5				

Neni 154 Shkatwrrim prone me mjete te tjera						1		2		
Neni 161 Shkatwrrim prone nga pakujdesia						3	2	2	2	
Totali	11					11	3	7	4	
V.P/ nw fushwn e doganave.	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 178 tregtimi mallrave kontrabande						1	1	1	1	1 gjobe
Totali						1	1	1	1	1
V.P/ Me tatimet dhe taksat	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 180 Fsheje te ardhurave						1		1		
Neni 181 Mospagimi taksave e tatimeve	2		1							
Neni 182 Ndryshimi nw aparatet matese	2		2							

Totali	4		3			1		1		
V.P/Falsifikimit te monedhave letra me vlere.	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 183 Falsifikimi monedhave						1		1		
Totali						1		1		
V.P.K/ Falsifikimit te dokumentave	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
neni 186/1 Falsifikimi dokumentave	4	2	4	3	1neni 59	8		3		1pafaj

Neni 186/2 falsifikim nw bashkwpunim	1	1	2	2		1		1	2	
Neni 186/3 Falsifikimi nga personi qe ka per detyre	1		1							
Neni 189 Falsifikimi leternjoftimeve vizave	2		2			1		1		
Neni 190 Falsifikim formulareve						1		1		
Totali	8	3	9	5	1	11		6	2	
V.P.K/Lojrave te fatit	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pan d. Per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pan d per gjkim	Nr. Pand denuar
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kol ona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kol ona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 197 Organizimi lojrave te fatit	6	1	6	1		1	5	1	1	4den+ 1paf
Neni 198 Venia ne dispozicion e lokaleve per lojra	1	1	2	2		1		1		
Totali	7	2	8			2	5	2	1	4
V.P.K/Regjimit te tokes dhe ndertimeve.	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pan d. Per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pan d. Regj	Nr. Pan d per gjkim	Nr. Pand denuar

	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 199a/1 ndertimi paligjshem	4	1	3	1		2		3	2	1 gjobe.
Neni 199a/2 Ndertimi paligjshem ne token e tjetrit	2	1	1	1	1 neni 59		1			1 burg mes
neni 200 Pushtim tokes						1				
Totali	6	2	4	2	1	3	1	3		2
V.P.K/Mjedisit.	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra baraz me kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra baraz me kolonat 112+120					
Neni 205 Prerje pyjeve						5		1		
Neni 206 Prerja e drureve dekorativ						1		1		
Totali						7		3		
V.P.K/ Autoritetit shtetror kryer nga shtetasit	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per	Nr. Pandenuar

V.P.K/Rendit dhe sigurise	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 272 Njoftimi rreme ne organet e rendit	1		1							
Neni 273 largim nga vendi ngjarjes						1	1	1	1	1 burg mes
Neni 275 Pwrdorimi me keqdashje thirrjeve telefonike	8	2	2	2		7				2 gjobe
Neni 277 Vetegjyqesia	3	1	3	1						1 gjobe
Neni 278/4 Prodhimi dhe mbajtje e armeve	1	1	1	1	1 burg mesa					
Neni 280 Mbajtja pa leje armeve te gjahut	1					4		7	6	
Neni 283 Prodhimi dhe shitje narkotikeve	1		5							
Neni 284/1 Kultivim te bimeve narkotike	12		2			38	2	3	2	2 neni 59
Neni 284/2 Kulivim ne bashkepunim	1		3			2	2	1	3	2 burg
Neni 287 Pastrim produkteve vepres penale						2				
Neni 288a Pordhim pa ligjshem artikujeve ushqimor	1	1	1	1	1 gjobe					
Neni 290/1 Shkelje rregullave me pasoje plagosje lehete						2		2		
Neni 290/3 Shkelje rregullave te qarkullimit me pasoje vdekj						1	1	1	1	
Neni 291 Drejtim ne gjendje te parregullt.	6	6	7	6	4 neni 59	3	2	3	2	4 neni 59

V.P.K/Zgjedhjeve	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
	Shifra barazme kolonen nr 15	Kolona nr 70	Shuma e kolonave 16+17	Kolona 71	Shifra barazme kolonat 112+120					
Neni 326 falsifikim materialit zgjedhor	1									
Neni 326a Demtim materialit zgjedhor	1									
Totali	2									
	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenuar
Totali per dy vitet	137	46	95	52	24	162	41	116	66	49

4. Në vitin 2016 janë dërguar 41 procedime penale për gjykim me 66 të pandehur, nga të cilët 21 me masë sigurimi “Arrest në burg”, 1 arrest në shtëpi dhe 8 detyrim paraqitje ne policine gjyqësore.

- Me gjykim te drejtpërdrejt janë zhvilluar 5 çeshtje me 6 te pandehur, 3 në gjendje të lirë, 2 detyrim paraqitje ne policine gjyqësore,një arrest në burg.
- Janë zhvilluar 17 çeshtje me gjykim te shkurtuar, me 23 te pandehur te deklaruar fajtor.
- Me gjykim të zakonshëm 19 gjykime nga të cilat kanë përfunduar 9 gjykime ne shkallë të parë.

Vendimarrja e gjykatës shkallës parë është dhënë për 34 të pandehur duke vendosur.

Kanë marrë pafajesi 5 të pandehur.

Dënuar me gjobë 6 të pandehur

Dënuar me burg në minimum 1 i pandehur

Me burgim ne masen mesatare qe parashikon dispozita 9 të pandehur.

Dënuar me denime alternative,pezullim te denimit me burg sipas nenit 59 K.Penal ose punë në interes publik parashikuar nga neni 63 K.Penal 13 të pandehur.

Janë mbartuar në gjykim për vitin 2017, 13 çeshtje me 32 të pandehur, nga të cilët 13 me masë sigurimi arrest në burg, 4 me detyrim paraqitje ne policine gjyqësore dhe 15 gjykohen ne gjendje te lirë.

4.1 Në përgjithesi kerkesat për masat dhe llojet e dënimeve të kërkuara nga Prokurori çeshtjes janë mbeshtetur dhe pranuar nga gjykata me përjashtim të rasteve.

- Për një të pandehur akuzuar për veprën penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284/1 K.Penal, për tre rrënjë të kultivuara cannabis, prokurori ka kërkuar aplikimin e dënimit alternativ.Gjykata e Shkallës Parë Përmet, ka vendosur dënimin me tre vjet burg, pas ankimit nga i dënuari në Gjykatën e Apelit është vendosur sipas kërkesës së prokurorit pezullimi dënimit me burg.
- Për një të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga neni 280 dhe 84 K.Penal, prokurori ka kërkuar dënimin me gjobë të dënuarit, gjykata e shkallës parë ka vendosur dënimin me 2 muaj burg. Pas apelimit te dënuarit Gjykata e Apelit ka vendosur lojin e dënimit të kërkuar nga prokurori.
- Për një të dënuar për veprën penale të “Vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 K.Penal, zhvilluar me gjykim te shkurtuar prokurori ka kërkuar 15 vjet burg. Gjykata e Shkallës parë ka vendosur dënimin e tij në minimum dhe përfundimisht me 6 vjet e tete muaj burg dhe pas ankimit nga prokurori nuk është ndryshuar masa e dënimit.
- Për një të dënuar për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134/2 K.Penal, prokurori ka kërkuar dënimin me gjashtë muaj burg. Gjykata ka aplikuar nenin 59

K.Penal duke pezulluar dënimin me burg. Nga prokurori cështjes është hequr dorë nga ankimi duke pranuar vendimin e gjykates shkalles pare.

- Për një të akuzuar për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/2 K.Penal, prokurori ka kërkuar aplikimin e dënimit alternativ, pezullimin e dënimit me burg. Gjykata ka vendosur dënimin e tij me katër muaj burg dhe pas ankimit nga i denuari në Gjykatën e Apelit vendimi Gjykatës Shkallës Parë Përmet është lënë në fuqi.
- Per dy te akuzuar per veprat penale te “Moskallezimit te krimit” parashikuar nga neni 300 K.Penal, prokurori ka kërkuar aplikimin e dënimit alternativ, me pezullim te dënimit me burg.Gjykata ka vendosur pushimin e ceshtjes dhe pafajesi. Aktualisht ceshtjet janë duke u gjykuar ne Gjykatën e Apelit Gjirokaster, pas apelimit të prokurorit.
- Për një të pandehur, akuzuar per veprën penale te “ Organizimit te pa lejura te lojrave të fatit” parashikuar nga neni 197 K.Penal, prokurori ka kërkuar dënimin me gjobe, gjykata ka vendosur pafajësi, vendimarrje që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.
- Për një të akuzuar për veprën penale te “ Pengimi për ekzekutimin e vendimit te gjykates” parashikuar nga neni 320 K.Penal, prokurori ka kërkuar aplikimin e dënimit alternative, me pezullim te dënimit me burg.Gjykata ka vendosur pafajësi, vendimarrje që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit edhe pas ankimit nga prokurori.
- Për një të pandehur akuzuar për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjëseve që kryejne nje funksion publik” parashikuar nga neni 235 K.Penal, prokurori ka kërkuar deklarimin fajtor gjykata ka vendosur pafajësi është bërë ankim pritet vendimi Gjykatës Apelit.

4.4 Të pandehurit e derguar për gjyq rezulton se pjesa me e madhe e tyre janë të padënuar me parë, banor në zonat rurale dhe të papune ose te vete punësuar.Me përjashtim të 10 pandehureve te denuar me pare dhe 2 prej tyre kanë qënë përsëritës të së njëjtës vepër penale.

Në lidhje me arsimimin rezulton se 35 janë me arsim teteklase, 30 me arsim te mesem nje me arsim te larte dhe vetem 2 jane te gjinisë femerore.

Banor të rrethit Përmet janë 46 të pandehur në qytetet Këlcyrë dhe Përmet dhe në zonat rurale, pjesa me e madhe janë të papune ose vete punesuar ne bujqesi.

Banor të rretheve te tjera janë 20 të pandehur, 5 të rrethit Tepelene, 2 të rrethit Vlore, 2 te rrethit Gjirokastër, 5 te rrethit Skrapar, 1 te rrethit Durrës, 4 me vendqendrim në Tiranë dhe 1 me vendqendrim ne shtetin Grek.

Personat jo banor te rrethit Përmet, akuzohen dhe janë marrë të pandehur për vepra penale kryesisht krime dhe me rrezikshmeri te theksuar shoqerore si “Vrasje me dashje” parashikuar nga neni 76 dhe “Vrasje ne lidhje me nje krim tjetër” parashikuar nga neni 77-22 K.Penal katër të pandehur. Për veprën penale “Prodhim dhe shitje te lendeve narkotike” parashikuar ga neni

283/2 K.Penal 6 te pandehur. Për veprën penale “Shkelje e rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/3 K.Penal.

4.5 Për shkakun se në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet, nuk ka seksion për të miturit, në çdo rast që është konstatuar nga shërbimet e policisë përfshirja e të miturve në krime ose kundervajtje, janë urdhëruar shërbimet e policisë gjyqësore ta referojnë rastin dhe materialet, menjëherë në Seksionin e të miturve pranë Prokurorisë Shkallës Parë Gjirokastrë.

5. Në fushën e mardhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, vlen për tu thkesuar së në ndryshim nga vitet paraardhese është kërkuar dhe urdhëruar shpallja për kërkim ndërkombëtar për 11 të pandehur, hetuar me masë sigurimi arrest në burg për vepra penale të rënda aktualisht të gjithë janë në gjyq dhe tre prej tyre janë dënuar me burg me vendim te formes së prerë.

6. Ngarkesa Sipas Prokuroreve.

Prokurore Silvana Pani gjatë vitit 2016 ka hetuar 97 procedime penale dhe 37 kallëzime.

Për 22 procedime penale ka vendosur dergimin në gjykim me 28 te pandehur

Ka aplikuar gjykimin e drejtpërdrjet për 3 çështje me tre te pandehur.

Ka zhvilluar me gjykim te shkurtuar 12 çështje.

Për 20 çështje ose proçedime ka vendosur pushimin e procedimit penal, me 7 persona ne hetim.

Ka vendosur moskompetencen per 6 çështje me 6 person në hetim.

Për 20 çështje ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

Mosfillimin e procedimit penal për 37 materiale kallëzuese.

Ka mbartuar 29 procedime penale me 10 persona në hetim,3 me mase sigurimi detyrim paraqitje ne policine gjyqësore dhe 7 ne gjendje te lire.

Ka marrë pafajësi ne dy gjykime me tre te pandehur te akuzuar per veprat penale te “Pengimi te ekzekutimit te vendimit gjyqesor” parashikuar nga neni 320 K.Penal dhe “Kanosjes” parashikuar nga neni 84-25 K.Penal.

Konstatohet se kryen hetime te thjeshtezuara dhe pergjithesisht i përfundon hetimet paraprake brenda afatit tre mujor.

Zgjatje te hetimeve paraprake ka marrë për 7 proçedime penale dhe afati është zgjatur për arsye objektive dhe mungese te kryerjes se akteve te ekspertimit ne kohe.

Janë shfuqizuar nga prokurori më i lartë, tre vendime pushimi.Shfuqizuar një vendim për pushimin e çështjes per vepren penale te “Falsifikimit te dokumentave” parashikuar nga neni 186 K.Penal me nje person ne hetim. Një vendim pushimi, për 7 persona në hetim, katër të dyshuar per vepren penale te “ Ndhimë për kalim të paligjshëm te kufirit” parashikuar nga neni 298/3

K.Penal dhe 3 për veprën penale të “Shpërdorimit të detyres” parashikuar nga neni 248 K.Penal. Nje vendim për pushimin e çështjes për veprën penale të “ Shkatërrimit të pronës” parashikuar nga neni 150 K.Penal ne ngarkim te tre personave ne hetim.

Prokurori Asllan Barjamaj ka hetuar 107 procedime penale dhe 32 kallëzime duke vendosur si më poshtë.

Dërguar për gjykim 19 proçedime me 38 te pandehur, për 2 çështje ka aplikuar gjykimin e drejpërdrejt me tre te pandehur.

Pushimin e hetimeve për 29 proçedime penale, me 13 persona në hetim ne gjendje te lirë.

Pezullimin e hetimeve për 17 proçedime penale.

Vendim për shpallje moskompetence dhe kalimin e akteve për 2 proçedime penale me 2 persona në hetim.

Ka mbartuar 39 proçedime penale për vitin 2017, me 10 persona ne hetim,2 hetohen me masën e sigurimit personal “arrest në burg” në mungese, 2 arrest në shtëpi, 1 detyrim paraqitje ne policine gjyqësore.

Për katër çështje me 5 te pandehur ka marrë pafajësi të akuzuar si me poshte.

Në një çështje me akuzën e “Falsifikimit të dokumentit” parashikuar nga neni 186/2 K.Penal me një të pandehur hetuar ne gjendje te lire.

Një gjykim me një të pandehur akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 K.Penal. Gjykata e Shkallës Parë Përmet e ka shpallur fajtor dhe dënuar me nje vit burg. I pandehuri është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur shpalljen të pafajshëm.

Për një të pandehur me akuzën për veprën penale të “Organizimit të palejuara të lojrave te fatit” parashikuar nga neni 197 është marrë pafajësi në të dyja shkallët.

Në gjykimine nje ceshtje me nje të pandehur akuzuar për veprën penale “Pengim të punonjeseve publik për të ushtruar detyrën” parashikuar nga neni 235/1 K.penal.

Janë marrë dy pafajësi të pjesshme në dy gjykime me dy të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit” parashikuar nga neni 300 K.Penal është bërë ankim në Gjykatën e Apelit dhe pritet vendimi.

Ka marrë zgjatje hetimesh për 15 çështje, zgjatjet në pjesën më të madhe janë marrë për mos kryerjen e akteve te ekspertimit nga policia shkencore ne kohe. Për tre procedime penale për veprat penale të “Vrasjes në lidhje me një krim tjetër” parashikuar nga neni 77-22 dhe “Vrasje me paramendim” parashikuar nga neni 78/2-22 K.Penal dhe “Shkeljes se barazisë në tendera” parashikuar nga neni 258 K.Penal, zgjatjet janë marrë për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe numerit te madh të veprimeve hetimore që duhet të kryhen.

Ka udhëruar ndalimin e dy personave, ka kërkuar vendosjen masave të sigurimit personal për 6 persona në hetim, kërkesa të pranuar dhe miratuara nga gjykata.

Prokurori Spartak Çoçoli, ka hetuar për afatin 2 mujor, 12 procedime penale dhe 11 materiale kallëzuese, ka vendosur mosfillimin për pesë procedime penale.

Seksionet e Policisë Gjyqësore.

Sa i përket policisë gjyqësore të seksionit pranë Prokurorisë Shkallës Parë Përmet, rezultojnë se është kryer një punë e konsiderueshme për vitin 2016, nga oficeri Agron Nakollari. Ka pasur në hetim 70 procedime penale të deleguara nga prokurorët dhe 15 kallëzime penale.

Për 14 procedime ka referuar dërgimin për gjykim. Kryen detyrat e deleguara dhe urdheruara nga prokurori në mënyrë profesionale dhe është aktiv në hetim duke kryer dhe veprime hetimore me iniciative që rezultojnë efektive për ecurinë e hetimeve.

Shërbimet e policisë gjyqësore në Komisarjatin e Policisë Përmet dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë, kanë kryer 168 referime për vitin 2016 dhe janë deleguar dhe kanë hetuar 90 procedime penale. Bazuar në urdhërat me shkrim të delegimit të kryera nga prokurori, kanë përfunduar dhe kryer veprimet e deleguara në afatin e përcaktuar përgjithësisht. Shqetësim mbetet mënyra e hetimit të veprave penale të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal. Në asnjë rast, pavarësisht sasisë së bimeve narkotike të kultivuara, vendodhjes së tyre, nuk është njoftuar paraprakisht prokurori, me qëllim për tu bërë pjesë aktive e hetimit, për identifikimin e autoreve, për të kryer veprime hetimore speciale dhe posaçërisht që do të ndihmojnë hetimin dhe identifikimin e autoreve. Kërkohej një hetim me thellësi dhe detajuar pikërisht për faktin penal të “Kultivimit të bimeve narkotike” parashikuar nga neni 284 K.Penal dhe “Prodhim dhe shitje narkotikeve” parashikuar nga neni 283 K.Penal.

7. Buxheti për vitin 2016 është zbatuar në mënyrë korrekte dhe pas një auditimi të kryer në vitin 2016, janë marrë masat për të rregulluar problematikat në dokumentacion që janë vërejtur nga auditimi. Konstatohet një buxhet mjaft i kufizuar dhe jo i mjaftueshëm për të kryer investimet në mbajtjen e paisjeve të punës, bazës materiale dhe për vitin 2017 kjo problematikë ekziston.

Mardheniet me publikun kanë qënë jo problematike dhe brenda kornizave që përcakton ligji. Ende nuk është vënë në dispozicion zyra që mbahet nga Përmbartuesi Gjyqësor Përmet por që është në inventar të Prokurorisë.

Godina e ish hetuesve në inventar të Prokurorisë është jashtë funksionit dhe kërkojmë të merren masa për kalimin e saj në pronësi të organeve të tjera shtetërore ose investimit dhe kthimin në gjendje optimale dhe funksionale.

Ka shqetësim sa i përket bazës materiale dhe konkretisht mungon një automjet funksional për të kryer levizjen e punonjeseve për arsye pune është kërkuar disa herë një automjet ne gjendje pune, por ende nuk e disponojme nje te tille. Ekzistuesi është prodhimi i vitit 1990 dhe është jo funksional si nga ana motorike dhe xhenerike.

Në lidhje me organikën kerkohet shtese per një punonjëse për të kryer funksionin e sekretares dhe detyra te tjera administrative.

Respektimi disiplinës në punë dhe etikës ka qënë korrekt nga punonjësit.

8. Për vitin 2017 përparësi kryesore është lufta kundër fenomenit të “Kultivimit të bimeve narkotike” në zonat rurale te rrethit Përmet, shtimi numërit të personave në hetim dhe të marrë në përgjegjsi penale për këtë vepër penale.

DREJTUESI PROKURORISË
Asllan BARJAMAJ.